



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 39/2024 (JR)
Nr. 39/2 regj.

Tiranë, më 23.12.2025

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se **ditën e martë, në datën 27.01.2026, ora 10.00**, do të shqyrtohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri (JR) 39/2024, datë 15.10.2024 për ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 774, datë 14.06.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Petrit Vukaj.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykues
Relatore e Çështjes
Gjyqtare
Gjyqtare
Gjyqtar

Rezarta Schuetz
Albana Shtylla
Mimoza Tasi
Natasha Mulaj
Sokol Çomo

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në ambientet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në faqen e internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Me njoftim individual njoftohet subjekti i rivlerësimit, në të dhënat elektronike të kontaktit të deklaruara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit si dhe në të dhënat elektronike të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES

GJYQTARE

REZARTA SCHUETZ
